



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0790

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Mobelland” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues per shkolla” me nr. të prokurimit: “208Udheheqesi-23-1024-1-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit me datën 29.12.2023, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Mobelland” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.10.2023 (me numër protokolli 790/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues per shkolla “ me nr. të prokurimit: “208Udheheqesi-23-1024-1-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit.

II. Anulohet, vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

III. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 21.02.2023, Ministria e Arsimit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues per shkolla” me nr. të prokurimit: “208Udheheqesi-23-1024-1-1-1”.

OE “Mobelland” SH.P.K. me datën 01.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 03.10.2023, AK- Ministria e Arsimit ,me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Mobelland” SH.P.K. me datën 13.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 790/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 350.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.10.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Mobelland” SH.P.K.

I. Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik“Mobelland” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 13.10.2023 (me numër protokollit 790/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues per shkolla “ me nr. të prokurimit: “208Udheheqesi-23-1024-1-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit.

II.Te mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Sqarim hyrës:

OE ankues me datë 01.10.2023 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në AK. Me datë 03.10.2023 AK ka marr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Pretendimi ankimor 1

- OE ankues pretendon se AK me vendimin e datës 25.09.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi që ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk plotëson kërkesat e

dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional lidhur me diplomën e menaxherit të projektit.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- AK në dosjen e tenderit tek kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional, ka përcaktuar kërkesën: *“1.Menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Inxhinier i diplomuar i teknologjisë së drurit apo master ose Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës apo master i Arkitekturës me pesë vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV 2. Inxhinier i diplomuar i Makinerisë, apo master i Makinerisë- (një), me tri vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme. Te pasqyrohen me listën e projekteve dhe CV.”* Si dëshmi dokumentare për përmbushjen e kërkesë është kërkuar: *“Dëshmia 1-2. Për menaxherin e Projektit dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse të noterizuara. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e notifikuar nga MASHTI. Kopjen e kontratave ose parakontratat mbi marrëdhënien e punës, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV e tyre, letër referencë në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit.”*
- OE i rekomanduar në ofertë ka dorëzuar dokumentin- *“Deklarate për menaxherin e projektit”,* në të cilin shënohet *“Per tenderin me titull Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues për shkolla, me nr te Prokurimit: 208 Udheheqesi-23-1024-1-1-1 Nr.i brendshëm: 208 23 002111, deklarojme se menaxher projekti do te jete z.Fitim Abdullahu i diplomuar si Inxhinier i perpunimit te drurit.”*
- Gjithashtu është dorëzuar Diploma e lëshuar nga Universitetit Bujqësor i Tiranë, në të cilën shënohet se z.Fitim Abdullahu, filloi studimet në vitin 2003 dhe i përfundoi në vitin 2009 në Fakultetin e Shkencave Pyjore, në Inxhinieri për Përpunim Druri, në formë me kohë të plotë. Kopja e diplomës është e noterizuar me numër Lrp.1637/2020 me datë 02.09.2020. Poashtu është bashkangjitur vendimi i datës 13.07.2010, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e Republikës së Kosovës, përkatësisht i Komisionit Kombëtar për njohjen e diplomave ku shënohet se z.Fitim Abdullahu i njihet grada universitare Diplomë të Integruar të nivelit të dytë në Inxhinieri për Përpunim Druri, fituar në Universitetin Bujqësor të Tiranës.
- Ndërkaq në lidhje me kërkesën 2 të kapacitetit teknik dhe profesional, është dorëzuar është dorëzuar Diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës, Fakulteti i Makinerisë, në të cilën shënohet se z.Avdi Fangu ka përfunduar studimet dhe merr titullin Inxhinier i Diplomuar i Makinerisë. Së bashku me diplomë është dorëzuar edhe vërtetimi i kopjes së noterizuar me numër Nr.Lrp 3498/2023.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se OE ankues gabimisht i referohet stafit E.D si menaxher i projektit pasi që sipas deklaratës së OE të rekomanduar në cilësinë e menaxherit të projektit në këtë aktivitet është deklaruar z.Fitim Abdullahu. Ndërsa në lidhje me plotësimin e kërkesës për diplomë për menaxherin e projektit, konform sqarimeve të mësipërme është evidente se OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmitë konform kërkesës së AK-së për menaxherin e projektit. Poashtu nuk qëndron pretendimi as për kërkesën 2 (Inxhinierin e makinerisë) pasi që është

dorëzuar diploma së bashku me kopjen e noterizuar për inxhinierin e makinerisë z. Avdi Fangu. Prandaj, sipas sqarimeve të mësipërme, OE i rekomanduar ka dorëzuar dëshmi dokumentare në lidhje me kualifikimin shkollor konform kërkesave të dosjes së tenderit, në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional, dhe për rrjedhojë pretendimi ankimor është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 2

- OE ankues pretendon se AK me vendimin e datës 25.09.2023 ka vepruar në kundërshtim të nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik (më tej RrPP) pasi që OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta.

Rrethanat e çështjes – në vijim janë paraqitur faktet dhe rrethanat procedurale relevante me këtë pretendim ankimor.

- Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave dhe raportit të vlerësimit, në këtë aktivitet kanë dorëzuar ofertë OE në vijim:
 1. OE "Mobelland" SH.P.K., me çmim të ofertës prej 164,105.00 euro.
 2. OE N.T.SH. Delfina; PRIME CORPORATION L.L.C.; Erzeni shpk: me çmim të ofertës prej 214,400.00 euro.
 3. OE NTP Blendi O.P.: me çmim të ofertës prej 197,733.00 euro.
 4. GOE WOOD CORPORATION L.L.C.; SEDEF AHSAP: me çmim të ofertës prej 196,094.76 euro
 5. OE "art & design" SH.P.K.: me çmim të ofertës prej 326,213.00 euro.
 6. OE "GRANITI SH.P.K": me çmim të ofertës prej 106,962.28 euro.
 7. GOE "IBM SH.P.K":; Majlinda Bajraktari B.I.: me çmim të ofertës prej 176,424.00 euro.
- Sipas njoftimit mbi vendimin e AK-së të publikuar nga me datë 12.05.2023, OE Graniti Sh.p.k është rekomanduar për shpërbllim me kontratë.
- Me datë 17.05.2023, OE "Mobelland" Sh.p.k. (tute OE ankues), si palë e pakënaqur me vendimin e AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 18.05.2023. OE ankues me datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 312/23, kundër vendimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.
- Paneli Shqyrtues i OSHP përmes vendimit numër: 312/23 të datës 06.07.2023 ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka obliguar AK të bëjë rivlerësimin e ofertave.
- AK me datë 02.08.2023, ka kërkuar sqarime shpesh nga OE i rekomanduar për kontratë, duke kërkuar shpjegime lidhur me çmimin jonormalisht të ulët.
- OE ankues me datë 03.08.2023 ka ngarkuar sqarimin ku ka përshkruar zbërthimin e çmimit të ofertës për 19 pozicionet.
- Me date 25.09.2023 AK ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku ka rekomanduar për shpërbllim me kontratë OE Graniti Sh.p.k.
- Përsëri, OE ankues si palë e pakënaqur me vendimin e AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 01.10.2023, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 03.10.2023. Në arsyetimin e refuzimit të këtij pretendimi, AK ka precizuar: "[..] OE GRANITI SH.P.K, përmes platformës e-prokurimi, ka dërguar një sqarim të detajuar për secilin pozicion të paramasës duke e sqaruar secilin çmim të ofertës dhe atë duke elaboruar Çmimin e lëndës së parë, Shpenzimet e ndryshme në fabrikë, Punëtorët e prodhimit në fabrikë, Tatimin,

Transportin (duke llogaritur dërgesën komplet) dhe fitimin. Në sqarimin e lartpërmendur, i njëjti ka treguar se me çmimin që ka ofertuar është çmim i tregut dhe marzhën e interesit e kanë 20% (pra fitimin sipas kësaj oferte e kanë 20%) duke theksuar se e kanë nënshkruar edhe deklaratën nën betim AK-MASHTI, duke u bazuar në arsyetimin e OE GRANITI SH.P.K.- Shirokë, do të zbatohet nën 29.4 E Rregullores së Prokurimit Publik, duke kërkuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, ti kërkohej një përqindje më e lartë e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, si garanci për përmbushjen e saj Vlen të ceket se në këtë procedurë të prokurimit gjatë rivlerësimit të tenderit kemi pasur vetëm dy oferta të përgjegjshme, pasi që ofertuesit tjerë nuk kanë bërë zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së tenderit të sigurimit të tenderit.”

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

- Eksperti sqaron se në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta të konstatuara sipas kritereve të nenit 41.3 të RrPP, AK ka zbatuar procedurën *inter partes* me OE të rekomanduar. Në lidhje me vendimin e AK-së pas pranimit të sqarimeve (zbërthimit të çmimeve) neni 41.10 i RrPP përcakton që AK pas pranimit të sqarimeve nga OE në lidhje me çmimet jonormalisht të ulëta nëse sqarimi është i mjaftueshëm, e trajton tenderin njëjtë me tenderët tjerë, ndërsa nëse sqarimi nuk mjafton, e refuzon tenderin. Në këtë kuptim është në diskrecionin e AK-së të vendosë duke u bazuar në sqarimet e pranuar dhe në këtë rast AK është bindur që sipas sqarimeve në lidhje me çmimet, të trajtojë ofertën e OE të rekomanduar si ofertë me çmime të besueshme. Për më tepër Eksperti sqaron se OE ankues përveç pohimeve nuk ka dorëzuar asnjë provë mbështetëse që mund të argumentojë pretendimin ankimor se çmimet e ofertës së OE të rekomanduar nuk janë të besueshme. Prandaj, AK ka vepruar në përputhje me nenin 1 dhe 6 të LPP-së dhe nenin 41 të RrPP, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me inventar plotësues për shkollë" me nr. të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1024-1-1-1, ka pasur vendim të nxjerrur nga OSHP me nr. 2023/0312 më dt. 06.07.2023 Paneli shqyrtues vlerëson se disa pretendime ankimore të cilat i ka paraqitur pala me ankesë, janë pretendime të cilat janë shqyrtuar nga ky paneli shqyrtues dhe për këto pretendime paneli në vendimin 2023/0312.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohej që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahës tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues.

Paneli në mbështetje të vendimit paraprak të OSHP dhe lidhur po pohimet ankimore sa i përket inxhinierëve të angazhuar eksperti shqyrtues mjaftë mirë dhe në mënyrë profesionale i ka paraqitur në ekspertizën e tij dhe paneli shqyrtues e mbështet këtë arsyeshmëri, dhe është e panevojshme që të shtjellojë përsëri secilën dhe të njëjtat i kualifikon si pretendime të pabazuara. Ndërsa, sa i përket pohimit ankimor ndaj të rekomanduarit se ka çmimeve jo-normalisht të ulëta, paneli shqyrtues nuk e mbështet ekspertin shqyrtues sepse nuk e ka japur asnjë argument lidhur me këtë përkundër se ankuesi specifikisht i ka përmendur në ankesën e tij dhe përgjigje në raportin e ekspertizës, aludimin për këto çmime si çmime të cilat nuk ka mundësi as të

realizohen. Paneli këtë çështje e ka veçuar dhe cituar se kjo është trajtuar me vendimin paraprak të lartëcekur të panelit shqyrtues duke e obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë sa i përket çmimeve të paraqitura në ofertë. Dhe kjo për paneli shqyrtues nuk ka si mos ta trajtoj ndryshme përveç si çështje e gjykuar, konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP, citat: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata". Andaj, nisur nga fakti se përveç që oferta është duksh[me më e ulët se ofertat tjera dhe vlera e parashikuar për këtë aktivitet është 350,000.00€ dhe këtë vlerë AK duhet ta vendos konform dispozitave në fuqi si me LPP ashtu edhe me Rregullore për Prokurim Publik, pas një hulumtimi të bërë të tregut, dhe nëse krahasohet me çmimin e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratës prej 106,962.28, atëherë i bie që të jetë më e ulët për mbi 300% se vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa, nëse krahasohet me mesataren e ofertave të 6 ofertuesëve të tjerë pjesëmarrës atëherë oferta e OE të rekomanduar për kontratë është rreth 100% më e ulët. Tutje në krahasohet me ofertën e dytë me radhë të përgjegjshme (pasuskeshme) atëher OE i rekomanduar për kontratë është rreth 34% më e ulët.

Duke pasur parasysh nenin 7 të LPP se të gjithë OE të trajtohen barabartë dhe duke u bazuar në nenin 61 të LPP, po ashtu edhe shembullit të jepur për klasifikimin e tenderit jo-normalisht të ulët tek nenit 11 i Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, si dhe si tërësi nenit 41 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, e në veçanti paragrafit 41.1, citat "Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

Paneli shqyrtues në bazë të sqarime të sipër përmendura dhe në mbështetje të dispozitave ligjore po ashtu edhe në bazë të arrin në përfundim se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është ofertë jo-normalisht e ulët dhe duhet të refuzohet si ofertë e papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar harmoni me dispozitat e nenit 24. 2, 59, 60 dhe 61 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e

individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E ARSIMIT**
- **OE - "Mobelland" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: